



FTESË PËR LANSIM PUBLIK

BE dhe Rrjeti i Grave të Kosovës lansojnë Analizën Gjinore të Kosovës

Biblioteka Kombëtare e Kosovës
3 tetor 2018, 14:15 – 16:00

Me 3 tetor, Zyra e BE-së në Kosovë/ Përfaqësuesja e Posaçme e BE-së në Kosovë Nataliya Apostolova, do të lansojnë Analizën Gjinore të Kosovës në bashkëpunim me Rrjetin e Grave të Kosovës në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës duke filluar nga ora 14:15. Folësit e tjerë në këtë takim do të jenë, Dhurata Hoxha, Ministre, Ministria e Integritimit Evropian dhe Mehdi Geci, Zëvendës Avokati i Popullit.

Hulumtuar dhe shkruar nga Rrjeti i Grave të Kosovës me kërkesën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Analiza Gjinore e Kosovës ofron informata aktuale mbi gjendjen e burrave dhe grave në sektorë të ndryshëm, duke filluar nga bujqësia, ekonomia, energjia, mjedisi, drejtësia, ndër të tjera.

Të kërkuara nga "Dokumenti i Punës i Stafit të Përbashkët - Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020", i njohur edhe si "Plani i Veprimit Gjinor i BE-së II" (GAP II). Kjo analizë ka për qëllim të informojë mbështetjen e ardhshme të BE-së për Qeverinë e Kosovës, veçanërisht lidhur me programet e Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA) dhe dialogjet e ardhshme politike.

Në të njëjtën kohë, ne shpresojmë që Analiza Gjinore e Kosovës mund të shërbejë si një dokument i rëndësishëm, të cilin Qeveria e Kosovës, donatorët, organizatat ndërkombëtare dhe aktorët lokalë të shoqërisë civile mund ta përdorin për të informuar punën e tyre aktuale dhe të ardhshme lidhur me përparimin e barazisë gjinore në të Kosovës.

Për më shumë informata ju lutem gjeni të bashkangjitur ftesën dhe agjendën.



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë